

VENDIM
Nr.989, datë 9.12.2010

PËR KRIJIMIN DHE MËNYRËN E PËRDORIMIT TË FONDIT TË EMERGJENCAVE CIVILE NË QARKUN E SHKODRËS, PËR TË PËRBALLUAR SITUATËN E SHKAKTUAR NGA PËRMBYTJET NATYRORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile” dhe të vendimit nr.968, datë 1.12.2010 të Këshillit të Ministrave “Për shpalljen e gjendjes së emergjencës civile (fatkeqësisë natyrore), në komunat dhe bashkitë në qarkun e Shkodrës”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e fondit financiar për emergjencat civile në qarkun e Shkodrës, ku do të përfshihen:

a) Shuma 300 000 000 (treqind milionë) lekë, nga Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH);

b) Donacionet monetare, të mbledhura nga llogaritë bankare, të çelura për këtë qëllim nga qeveria dhe njësitë e qeverisjes vendore;

c) Ndihamat materiale në natyrë nga donacionet.

2. Këto fonde përdoren vetëm me vendim të Komitetit Ndërmnistror të Emergjencave Civile dhe pagesat autorizohen nga prefekti i qarkut të Shkodrës.

3. Marrja në dorëzim e ndihmave materiale në natyrë bëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile, Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit dhe degët rajonale në varësi të saj, në Ministrinë e Brendshme.

4. Të gjitha ministritë e linjës, në bashkëpunim me kryetarët e njësisë të qeverisjes vendore, kryejnë procedurat (vlerësim, blerje, marrje në dorëzim etj.) për shpenzimet e kryera në sektorët që ato mbulojnë në kuadrin e marrjes së masave të emergjencës. Të gjitha këto shpenzime do të njihen si të tilla, vetëm pasi të vërtetohen nga prefekti i qarkut të Shkodrës.

5. Shpërndarja e ndihmave në natyrë sipas vendimeve të Komitetit Ndërmnistror të Emergjencave Civile bëhet dhe dokumentohet nga drejtoritë rajonale, në varësi të ministrive të linjës, apo në mungesë të tyre, nga vetë ministritë, dhe nga kryetarët e njësisë të qeverisjes vendore, sipas procedurave të përcaktuara në ligjin nr.8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile” dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave, dalë për këtë qëllim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha